

Dokument Politikash

Për ta bërë Kuadrin e ardhshëm Shumëvjeçar Financiar të BE-së të punojë në funksion të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave

Ky dokument politikash paraqet tre rekomandime të mbështetura nga një koalicion i gjerë ekspertësh dhe organizatash të shoqërisë civile (OSHC) për të udhëhequr institucionet e Bashkimit Evropian (BE) drejt një Kuadri Shumëvjeçar Financiar (MFF) me më shumë përgjegjshmëri gjinore. Ai synon të sigurojë që MFF-ja e ardhshme, pra buxheti i BE-së, të hartohet në një mënyrë që promovon barazinë gjinore përmes dispozitave të qarta, në përputhje me angazhimet ligjore.

[Neni 8](#) i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian përcakton: “Në të gjitha veprimtaritë e tij, Unioni synon të eliminojë pabarazitë dhe të promovojë barazinë midis grave dhe burrave.” Barazia gjinore është një e drejtë themelore, një vlerë thelbësore dhe një përparësi strategjike e BE-së, që mund të kontribuojë në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) dhe të forcojë sigurinë. [Instituti Evropian për Barazinë Gjinore](#) ka konstatuar së fundmi se ulja e pabarazisë gjinore mund të rrisë PBB-në e BE-së deri në 9.6% deri në vitin 2050 — një argument i fortë ekonomik për buxhetimin gjinor. Parlamenti Evropian, Këshilli dhe Komisioni janë zotuar të promovojnë barazinë, të drejtat dhe mundësitë për të gjitha gratë dhe burrat, si dhe integrimin gjinor në [Marrëveshjen Ndërinstitucionale aktuale](#), në MFF dhe në buxhetin e BE-së. Pavarësisht këtyre angazhimeve, [Raporti i Posaçëm i Gjykatës Evropiane të Audituesve](#) i vitit 2021 vuri në dukje:

Komisioni ende nuk e kishte përmbushur angazhimin e tij për integrimin gjinor në buxhetin e BE-së. Cikli buxhetor i BE-së nuk e merrte parasysh në mënyrë të mjaftueshme barazinë gjinore; i kushtonte pak vëmendje analizës gjinore të politikave dhe programeve të shqyrtuara; përdor në mënyrë të kufizuar të dhënat dhe treguesit të ndarë sipas gjinisë dhe publikon shumë pak informacion mbi ndikimin e përgjithshëm të buxhetit të BE-së në barazinë gjinore.

[Parlamenti Evropian](#) ka deklaruar se “shpreh keqardhje që Komisioni nuk ka kryer në mënyrë sistematike vlerësime të thelluara të ndikimit, përfshirë vlerësimet e ndikimit gjinor, për të gjithë legjisllacionin që përfshin shpenzime nga buxheti, dhe ngul këmbë që kjo të ndryshojë”. Parlamenti ka theksuar se “MFF-ja e ardhshme duhet të sigurojë që të gjitha programet e shpenzimeve [...] të promovojnë dhe mbrojnë të drejtat dhe mundësitë e barabarta për të gjithë, përfshirë barazinë gjinore”. Në veçanti, ai:

Përsëritet zhvillimin e një metodologjie për të gjurmuar shpenzimet me bazë gjinore dhe vlerëson se mësimet e nxjerra, veçanërisht në lidhje me mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë, monitorimin e zbatimit dhe ndikimit, si dhe barrën administrative, që duhet të zbatohen në MFF-në e ardhshme për të përmirësuar metodologjinë; i bën thirrje Komisionit të shqyrtojë fizibilitetin e buxhetimit gjinor në MFF-në e ardhshme.

Në këtë kontekst, më herët ka [përsëritetur](#) edhe punën e Komisionit për një:

klasifikim për të matur ndikimin gjinor të shpenzimeve të Bashkimit, duke konsideruar se ky klasifikim duhet të ofrojë një pasqyrim të saktë dhe gjithëpërfshirës të ndikimit të programeve në barazinë gjinore; kërkon që klasifikimi të zgjerohet në të gjitha programet e MFF-së dhe të integrohet më mirë në kuadrin e saj; thekson, në këtë kuadër, nevojën për mbledhjen dhe analizën sistematike të të dhënave të ndara sipas gjinisë; pret që i gjithë raportimi që lidhet me çështjet gjinore të bazohet në volumet financiare dhe jo në numrin e veprimeve.

Duke u bazuar në angazhimet e BE-së dhe këto rekomandime, ne, një koalicion prej më shumë se 150 organizatash të shoqërisë civile në shumë vende, i bëjmë thirrje Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit që, gjatë dialogut të ardhshëm trepalësh, të sigurojnë adresimin e rekomandimeve të mëposhtme në Kuadrin Shumëvjeçar Financiar (MFF).

1. Të sigurohet financimi për barazinë gjinore

Gratë vazhdojnë të përballen me pabarazi strukturore dhe diskriminim në të gjitha vendet e BE-së, siç tregohet nga [Indeksi i Barazisë Gjinore i BE-së](#), por edhe jashtë saj. Detyrimet ligjore për barazinë gjinore dhe angazhimet e BE-së (p.sh. [Strategjia e ardhshme për Barazinë Gjinore](#) e BE-së, Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore IV dhe Agjenda Gratë, Paqja dhe Siguria) do të kërkojnë financim për zbatimin e tyre. Për që MFF-ja e ardhshme të funksionojë në drejtim të barazisë gjinore, duhet të vendoset një objektiv ambicioz për shpenzimet në këtë fushë.

Rekomandime:

- Të vendoset një objektiv ambicioz për shpenzimet për barazinë gjinore në MFF (ashtu siç është bërë për shpenzimet për klimën).
- Të sigurohet që MFF-ja angazhon financim të mjaftueshëm për zbatimin e [Strategjisë së BE-së për Barazinë Gjinore](#), Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore IV dhe Agjendës Gratë, Paqja dhe Siguria.

2. Të kërkoet Buxhetim me Përgjigjshmëri Gjinore në të gjitha programet e financuara nga BE-ja

BE-ja duhet të zbatojë buxhetimin me përgjigjshmëri gjinore në punën e saj, duke vendosur një shembull pozitiv për qeveritë dhe duke përdorur praktikën më të mira të këtij buxheti për të përmirësuar transparencën, llogaridhënien, efikasitetin, efektivitetin dhe ndikimin e vet. Financimi duhet të bazohet në analiza të nevojave dhe të përfshijë një qasje ndërthurëse që adreson pabarazitë e ndërlidhura që prekin gra dhe burra të ndryshëm sipas moshës, etnisë, vendndodhjes gjeografike, (paftësisë), orientimit seksual dhe faktorëve të tjerë shoqërorë, ekonomikë dhe demografikë.

Rekomandime:

- Të përfshihen objektiva dhe tregues për barazinë gjinore në rregulloret e të gjitha programeve (përkatëse) të financimit, duke siguruar që fondet të orientohen drejt aktiviteteve që mbështesin në mënyrë të qartë barazinë gjinore dhe sektorët e dominuar nga gratë në të gjitha fushat politike.
- Të integrohet plotësisht barazia gjinore në kornizën e performancës që udhëheq MFF-në.
- Të përditësohet metoda e gjurmimit, duke siguruar që të përdoret si një mjet efektiv si në fazën paraprake (ex ante) ashtu edhe në atë pasuese (ex post), dhe që të gjenerojë të dhëna të besueshme për t'u përdorur në rishikimet buxhetore dhe planifikimin vjetor të buxhetit.
- Të përfshihet në Rregulloren për Dispozitat e Përbashkëta dhe në dokumentet e tjera ligjore që lidhen me MFF-në se: "Të gjitha shpenzimet e BE-së do të përfshijnë buxhetim me përgjigjshmëri gjinore, që përfshin kërkesat: i) vlerësime paraprake të ndikimit gjinor për të udhëhequr të gjitha shpenzimet gjatë fazës së hartimit; ii) vendosjen e objektivave për barazinë gjinore të shoqëruara me tregues të qartë, nivele fillestare, objektiva dhe shpenzime të planifikuara në nivel rezultatesh; iii) vlerësime përfundimtare të ndikimit gjinor si pjesë e të gjitha vlerësimeve; dhe iv) auditim vjetor të pavarur me fokus në barazinë gjinore."

3. Të sigurohet mbikëqyrja, monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve për barazinë gjinore

Gjurmimi i efikasitetit, efektivitetit dhe ndikimit të shpenzimeve dhe investimeve është thelbësor për transparencën dhe llogaridhënien ndaj taksapaguesve të BE-së, si dhe për monitorimin dhe vlerësimin e ndikimeve të shpenzimeve të BE-së në përmbushjen e objektivave të politikave. BE-ja është përballur me sfida në demonstrimin e përparimit të matshëm drejt avancimit të barazisë gjinore të lidhur me shpenzimet e saj. Disa nga sfidat kryesore kanë qenë: jo të gjitha ndërhyrjet kanë kryer vlerësime paraprake të ndikimit gjinor për të identifikuar nevojat e grave dhe burrave të ndryshëm dhe për të përcaktuar bazat fillestare; dhe sistemet e menaxhimit të të dhënave nuk lejojnë një konsolidim të lehtë të ndikimeve të lidhura me kostot e tyre në nivel kombëtar, rajonal apo global. BE-ja mund të gjurmojë shpenzimet drejt rezultateve (produkte, rezultate afatmesme, ndikim) duke

kërkuar nga përfituesit që të raportojnë mbi shpenzimet e lidhura me rezultatet. Kjo mund të ulë ngarkesën administrative për zyrtarët e BE-së në mbledhjen e të dhënave, të mundësojë raportim global mbi treguesit kyç dhe të lehtësojë monitorimin dhe vlerësimin e strategjive dhe ndikimeve të shpenzimeve të BE-së. Kjo do t'i ndihmonte institucionet e BE-së të vendosnin objektiva më të qarta për financimin e barazisë gjinore, të bazuara në nevoja, evidencë dhe mësimet e nxjerra. Nëse lidhet me ndërfaqe digjitale, kjo mund të përmirësojë ndarjen e informacionit, transparencën dhe llogaridhënien ndaj taksapaguesve, të cilët mund të shohin në kohë reale informacionin mbi shpenzimet dhe ndikimin.

Rekomandime:

- Legjislacioni që lidhet me MFF-në duhet të përfshijë një mandat për institucionet përkatëse, përfshirë Komisionin, që të përdorin një qasje të besueshme dhe sisteme digjitale më të avancuara dhe të përshtatshme për monitorimin dhe vlerësimin e produkteve, rezultateve dhe ndikimeve të lidhura me shpenzimet për barazinë gjinore.

This brief was written by the [Kosovo Women's Network](#) in collaboration with [Center for Research and Policy Making](#) for the [Gender Budget Watchdog Network](#), supported by the Austrian Development Agency (ADA) and Swedish International Development Cooperation Agency (Sida). The views herein are those of the authors and do not necessarily reflect the views of ADA and Sida. The European Women's Lobby and European Gender Budgeting Network contributed vital input and have endorsed the brief.